

Nikola Zdravkoviç

Skopska Crna Gora. Për kryeqytetin, mal mbrojtës. Mal në të cilin gjendet edhe fshati Kuçevishtë. Për disa nga vendasit bora paraqet mundësi për të pushuar. Për tjerët, mundësi për t'u mbledhur para zjarrit. Për të tretët, strehim nga jeta ...

Më 20 dhjetor të vitit 2010, buri im tani i vdekur Borislav Slavkoviç vdiq papritmas... u ndje keq, dhe derisa e dërguam në spital, për disa orë, na vdiq. Mbeta vet, si nënë. Më pas, shkova në Fondin pensional, që të sigurojë të ardhura për ekzistencë, duke marr parasysh se burri im ka punuar plotë 26 vjet. Kërkova pension familjar. – e fillon tregimin Gordana Slavkoviç.

Familja Slavkoviç gjatë natës ka mbet pa kreun e familjes. Gordana e cila tërë jetën ka qenë amvise, ka mbetur me dy djemtë e saj të cilët sapo kanë hyrë në botën e të moshuarve, dhe vet janë munduar që të kontribuojnë me ndonjë copë buke në tryezën modeste. 26 vitet të cilët babai Borislav i ka kaluar si punëtorë në varrezat në Butel, Gordana ka shpresuar se do të mund t'i sigurojnë ekzistencë.

Mu përgjigjen, se nuk kam 45 vjet. Burri im vdiq më 20.12.2010, ndërsa unë mbusha 45 vjet në shkurt. Një muaj e gjysmë më mungonin për të mbushur 45 vjet dhe ta trashëgoj pensionin me 50 vjet. Tani sipas ligjit, në momentin e vdekjes, burri ose gruaja duhet të kenë 45 vjet, që të trashëgojnë pensionin kur mbushin 50 vjet. Unë në atë moment nuk kisha, por askush nuk e di kur do t'i vijë dita e fundit, dhe ashtu... ndodhi ajo që ndodhi, parashtrova kërkesë, mu përgjigjën se mund të dërgoj ankesë brenda 15 ditëve, e bëra atë, dhe prap m'i kthyen dokumentet dhe më than se nuk kam 45 vjet, nuk kam as të drejte edhe pse jam nënë dhe kam fëmijë për të shkolluar. – shpjegon ajo.

Djali më i vjetër ka provuar që të fitojë ndonjë denar, prandaj familja ka vendosur që fëmija e vogël të mbarojë shkollimin si nxënës i çrregulltë, dhe në atë mënyrë ta fitojë pensionin e babait.

Çfarë bëra? Më 16 gusht e regjistrova djalin e vogël i cili aso kohe kishte 22 vjet dhe 8 muaj, të mësojë si nxënës i çrregulltë dhe të fitoj pensionin familjar. Më 16 gusht e regjistrova, në PISM shkuam më 18 gusht, i dorëzuam dokumentet, dhe më 19 gusht ndodhi edhe një fatkeqësi, më vdiq djali në kopshtin zoologjik, e mbyti rryma elektrike... mbeta pa shtyllën e familjes, mbeta pa djalin, dhe tani deri në fund të jetës nuk kam të drejtë të fitoj pensionin familjar... – e zbulon Gordana fatin tragjik të saj.

Pa të ardhura dhe me shtëpi të zbrazët, Gordana ka mbetur të masë copën e vogël të bukës dhe të mbajë llogari për dy varreza. Është lajmëruar në PISM, në Ministrinë e punës dhe politikës sociale, te Avokati i popullit. Përgjigjja gjithmonë ka qenë e njëjtë – na vjen keq për humbjen, por ligji është i qartë.

Pika 4 nga Neni 59 në Ligjin për sigurim pensional invalidor, thotë se vejushi ose vejusha mund të zbatojnë të drejtën për pension familjar në 50 vjet, por vetëm nëse në momentin e vdekjes së bashkëshortit kanë pasur 45 vjet të plota. Shumë njerëz nuk mund ta gëzojnë këtë të drejtë sepse disa javë i kanë ndarë nga mbushja e 45 viteve. Por, çfarë të bëjmë edhe me ato të cilët kanë pasur 45, por tani duhet të jetojnë deri sa të mbushin 50 vjet që të fillojnë të marrin këtë pension? Për institucionet, Ligji është gjithçka. A ka dritë në fund të këtij tuneli?

Sa njerëz kanë pasur fatin e njëjtë sikur Gordana, askush nuk e di. Evidencë për to nuk ekziston, ndërsa Gordana është e para që ka vendosur të flet para kamerës. Në labirintin e ligjeve, dera e Dimitar Apasiev është adresa e fundit në të cilën ekziston shpresë.

Nëse fryma e Ligjit është që nëpërmjet të pensionit t'u ndihmoni vejjshëve, ato të cilët kanë mbetur pa kreun e familjes, dikush që ka sjellë të ardhura, që ta përkujdeseni për të në këtë rast parashtrohet pyetja – pse nuk ka dispozitë e cila këtyre njerëzve do t'u jep të drejtë – nëse për shembull dakordohemi si shoqëri se 6 muaj është afati optimal, ose gjysmë viti ju mungon, të ketë disa opsione. Për shembull, vetëm ato 6 muaj mos të marrin pension dhe më pas do të marrin nga mosha 46 vjeçare, ose opsion që t'i paguajnë ato 6 muaj dhe më vonë të marrin pension. Në këtë rast asi dispozite nuk ekziston, mirëpo t'u mundësohet njerëzve të cilëve ju mungojnë disa muaj, për shembull optimumi është 6 muaj, unë sugjeroj të bëhet ndryshim i ligjit që ato njerëz të mund të zbatojnë të drejtat e tyre duke mos pritur edhe 5 vite të tjera deri sa të mbushin 50 që të zbatojnë të drejtën e tyre. – thotë juristi.

Kush disponon me lapsin i cili i shkruan ligjet? Përveç Kuvendit, a mund ta bëjnë atë edhe institucionet?

Gordana Slavkoviç, disa herë i është drejtuar PISM, por nga ana e tyre gjithmonë është kthyer me arsyetim të njëjtë – Ligji është i qartë. Por, duke marr parasysh se Fondi është institucion i prekur drejtpërdrejtë nga ky ligj, provuam t'i pyesim se a mund të marrin pjesë ato në plotësimin e ligjit ose në ndryshimin eventual të tij. Ju parashtrua pyetjet, por dhjetë ditë kaluan dhe ne ende nuk kemi përgjigje.

Përgjigjet që nuk i morëm nga PISM, i kërkuam prap nga juristët.

Në këtë rast nuk ekziston organ – edhe nëse dëshirojnë të ndihmojnë punonjësi ose drejtori i Fondit etj., atë nuk mund ta bëjnë sepse e thejnë Ligjin. Domethënë, mënyra e vetme është që të hapet diskutim i gjerë në komisionin në nivel të Kuvendit, dhe më vonë nëpërmjet të procedurës së rregulltë të ndryshohet ky ligj në mënyrë që të futen mekanizma mbrojtës të cilët do të parandalojnë situata që pa dyshim se nuk janë të drejta. – sqaron Apasiev.

A i konsideron Ligji këto qytetarë si dëm kolateral? A janë të vetëdijshëm deputetët për ekzistimin e tyre? Këtë pyetja ua parashtrua disa deputetëve, anëtarë të mëparshëm të komisionit të Kuvendit për punë dhe çështje sociale. Në atë komision, në fakt, është zgjidhja e problemit për njerëzit sikur Gordana. Të gjithë na thanë se janë të vetëdijshëm për ekzistimin e këtyre njerëzve, por edhe se ndryshimi i ligjit vështirë mund të ndodhë. Por, askush nuk dëshironte të thotë këtë para kamerës. Trokitëm edhe në derën e Ministrisë për punë dhe politikë sociale. Në vend të intervistës që ne e kërkuam, na dërguan letër në të cilën në fund duken përgjigjet.

Në kushte kur mosha është parakusht për fitimin e të drejtës të pensionit, çdo ndryshim në drejtim të zvogëlimit ose zmadhimit, prap do të krijojë kategori të personave të cilët nuk do të përfshihen në zbatimin e të drejtës së pensionit – deklaruan në përgjigjen e tyre.

Madje edhe nëse ndryshohet Ligji, a do të vlen vetëm për ato të cilët do të ballafaqohen me këtë problem në të ardhmen, ose do të ju ndihmojë atyre të cilët kanë ngritur zërin e tyre? Shpresojnë në Kushtetutën,

sipas të cilës çdo ndryshim i ligjit mund të vlejë edhe në mënyrë retroaktive nëse është në favor të qytetarëve. Por që të vijë deri aty, ka edhe shumë rrugë për t'u kaluar.

Gordana e fillon vitin e shtatë në atë rrugë. Mundohet të prekë deri te ato të cilët janë shpresa e vetme për atë – ato të cilët vijnë nga populli për t'i ndihmuar popullit. Deputetët. Për Gordanën, ditët moti nuk kanë as orë, as minuta. I kalon shpesh aty ku djali dhe buri janë të varrosur.

Unë nuk kërkojë lëmoshë, nuk dua askush të më ndihmojë. Unë dua për ato 26 vite të cilët i ka punuar burri, të më pranohet e drejta. Të bëhet ndonjë korigjim. Askush nga ne nuk di se kur do të shkojë në botën tjetër... duhet të ketë ndonjë korigjim. Tyre iu mungon një muaj e gjysmë, e unë mund t'iu fali 26 vite? Dhe duhet të vuaj për bukë, dhe mos të kem as një denar të vetëm... tani ishte Viti i ri, mos të kem para për t'i blerë mbesës një pako me ëmbëlsira... kjo nuk është në rregull, nuk është në rregull! Dhe mos të kam para për të ndezur një qiri për djalin... Ishte dita e kujtimit e të vdekurve, e unë të kërkojë para nga djali tjetër për të ndezur qiri?! – e mbaron tregimin Gordana.

Për Gordanën dhe ato të cilët e kanë fatin e njëjtë, tërë shpresën e kanë në përfaqësuesit e ri të Komisionit për punë dhe çështje sociale. Duan të besojnë se ato do të kujtohen në njerëzit të cilët janë dëshmitarë se, drejtësia nuk është gjithmonë e drejtë...